



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 739/p Prot.

Tiranë, më 28/09 /2023

VENDIM

Nr. 43, DATË 28/09 /2023

PËR

“MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT III PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” NË MUZIKOLOGJI NË NJËSINË BAZË KMDP, NË FAKULTETIN E MUZIKËS SI DHE MIRATIMIN E EMËRTESESË SË PROJEKTIT KËRKIMOR PËR VITIN 2023-2024, SI EMËRTESE E DYTË, NË FAKULTETIN E MUZIKËS, UNIVERSITETI I ARTEVE”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 3, 38, 77 e vijues; në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar; në Statutin e UART, nenet 24, 103, 106, 107, si dhe shkresën Nr. 794 Prot., datë 25.09.2023 të Dekanit të FM me lëndë “Mbi rregulloren dhe projektin kërkimor të programit të Ciklit III për fitimin e titullit “Doktor” në Muzikologji”, pas shqyrtimit dhe diskutimeve,

V E N D O S I:

1. Në Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit të III për Fitimin e Gradës Shkencore “Doktor” në Muzikologji në Njësinë Bazë të KMDP-së në Fakultetin e Muzikës, të miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 34, datë 17.11.2022, neni 16, gërma c) ndryshohet si më poshtë:
 - c) Në vlerësimin e kandidatëve, prioritet do të ketë stafi akademik me kohë të plotë dhe stafi akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Muzikës.
2. Miratimin e emërtesës - “Muzika në shoqërinë shqiptare” - të projektit kërkimor për vitin akademik 2023 – 2024, si emërtesë e dytë, krahas projektit kërkimor të vitit 2022-2023, në të cilin mund të aplikojnë kandidatët.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, Koordinatorin e programit të Doktoratës dhe Fakultetin e Muzikës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

4. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

100

100

100